## Libër për mësuesin/en

Art muzikor 6

Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: https://www.botimepegi.al/

ISBN: 978-9951-843-39-3

Majlinda Hala

# Libër për mësuesin/en

## Art muzikor 6




BOTIME
pegi

Dr. Majlinda Hala

# LIBËR PËR MËSUESIN/EN
# ART MUZIKOR 6

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME

pegi

Prishtinë, 2024

**BOTIME**

pegi

Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t:
?????????????
Korrektore letrare: Ergys PETIRTI
Paraqitja grafike: Ilmi SHAHU
Kopertina: Florinda ZONJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-39-3

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, maj 2024
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht
të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim,
përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht
ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

*Të gjitha tekstet letrare dhe joletrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar për qëllime didaktike.*

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
**Sektori i shpërndarjes: cel:** +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
**e-mail:** marketing@botimepegi.al
**Shtypshkronja Pegi**: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

## I. HYRJE

Muzika kontribuon në zhvillimin fizik, emocional, intelektual, social dhe estetik të fëmijëve, pra në formimin e gjithanshëm e posaçërisht në formimin kulturor të tyre, duke ua pasuruar botën shpirtërore, identitetin dhe personalitetin. Me gjuhën universale, të cilën e kuptojnë të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie e moshe, muzika u ndihmon nxënësve të kuptojnë dukuritë dhe proceset muzikore për t'i shfrytëzuar ato për komunikim dhe shprehje artistike në kontekste të ndryshme.

Si aktivitet shoqëror që prej zanafillës së shfaqjes së vet, muzika është mediumi që mundëson aktivitete të përbashkëta në grup ku kërkohet bashkëpunimi në realizimin e këngëve, pjesëve muzikore me instrumente etj., duke u mundësuar nxënësve që të zhvillojnë shkathtësitë e ndryshme muzikore, krahas zhvillimit të aftësive të tjera të përgjithshme.

Lënda "Art muzikor" në klasën e gjashtë synon:

- të identifikojë prirjet dhe zhvillojë shkathtësitë muzikore të nxënësve sipas interesimit dhe prirjeve individuale - veshin muzikor, këndimin, luajtjen në instrumente etj.;
- të pasurojë "fjalorin" e termave dhe të koncepteve bazë të gjuhës muzikore, për të mundësuar komunikimin artistik dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të nxënësve për ritmin, melodinë, harmoninë, format muzikore, instrumentet, institucionet, krijuesit dhe performuesit;
- t'i aftësojë nxënësit që të familjarizohen me dëgjimin aktiv muzikor dhe të çmojnë e vlerësojnë krijimtarinë muzikore (kombëtare dhe botërore) të stileve dhe zhanreve të ndryshme muzikore;
- t'i nxitë nxënësit që të provojnë aftësitë e tyre krijuese muzikore;
- të identifikojnë krijuesit dhe performuesit, institucionet dhe ngjarjet e rëndësishme muzikore.

## II. STILET E TË NXËNIT, PJESË E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ARTIT MUZIKOR, KLASA 6

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një fazë që kërkon t'i japë njohuritë e duhura nxënësit, të nxitë nevojat, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate pikërisht në rast se nxënësit kanë nxitje për të nxënë dhe kur secili/a nxënës/e mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënit.* Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit,* të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar,* disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit,* disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike. Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënit, janë mësimdhënësit ata që - gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor - nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe i vënë këto metoda në zbatim përmes stileve të të nxënit. Mësimdhënësit në mësimin e muzikës duhet të përdorin më shumë demonstrimin, bisedën, lojën me role, reflektimin, diskutimet. Suksesi gjatë procesit mësimor kërkon nga mësimdhënësi që t'i njohë dhe zbatojë stilet e të nxënit. Mësimdhënësi duhet të njohë mënyrën se si mësojnë nxënësit, moment shumë i vlefshëm për planifikimin e punës mësimore, të njohë llojet e stileve të të nxënit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në funksion të stileve të përdorura. Disa nga stilet e të nxënit, janë:

**II.1. Stili i të nxënit pamor është** kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast, mësimi konkretizohet duke përdorur mjete mësimore si: *fotografi, grafika, piktura, ngjyra, ilustrime, instrumente muzikore, DVD (ku ndërthuret edhe stili dëgjimor).* Të nxënit përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi, ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një ndodhi, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore;
- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

**II.2. Stili i të nxënit dëgjimor është** kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet *dëgjimeve të fragmenteve muzikore, improvizimeve* përmes lëvizjeve trupore, krijimeve *nëpërmjet* përjetimit nga dëgjimi i muzikës kur bëhen krijime të ndryshme dhe diskutohet për to. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi, ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës dhe edukimin e përqendrimit për të dëgjuar muzikë;
- dëgjimin e muzikës dhe mësimin e këngëve për fëmijë apo këngëve-lojë dhe diskutimin në lidhje me tekstin dhe melodinë e këngës;
- dëgjimin e muzikës dhe improvizimin përmes lëvizjeve trupore apo vizatimit në kontekstin e temës mësimore;
- dëgjimin e muzikës dhe nxitjen e bisedave apo diskutimeve në lidhje me fragmentin muzikor që dëgjoni;
- dëgjimin e muzikës dhe prezantimin e krijimeve të ndryshme të krijuara nën përjetimin e muzikës.

**II.3. Stili i të nxënit kinestetik është** kur nxënësi përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke *vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar* etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

> e prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore;
> i përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat;
> përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënit, nxënësit zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme p.sh.: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore apo aktivitete në grup, performime muzikore dhe kërcimore në shfaqjet skenike, kërcim apo

teatër, biseda në lidhje me temën e mësimit etj.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore muzikore, duke i përdorur ato përmes teknikave dhe metodave të mësimdhënies.

Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimit të muzikës, ku ndihmojnë edhe stilet e të nxënit, janë si më poshtë:

1) *Mësimi i këngëve* bën pjesë në stilin e *të nxënit pamor, dëgjimor, por edhe kinestetik,* sepse këngët duhet:
   - të mësohen;
   - të këndohen, duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe mësuar repertorin e sugjeruar;
   - të shoqërohen edhe me instrumente muzikore popullore, por edhe ORF;
   - të shoqërohen me lëvizje trupore.
2) Në fushën e *lojës me instrumente muzikore*, mësuesi bashkëpunon dhe synon vënien në përdorim të funksionit të muskujve të duarve gjatë luajtjes në instrument muzikor, duke i angazhuar nxënësit në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare, të ngjashme edhe me instrumentet ORF, për *shoqërimin e këngëve* që këndojnë.
3) *Dëgjimi muzikor* bën pjesë në stilin e *të nxënit pamor, dëgjimor, por edhe kinestetik,* sepse edukon përqendrimin dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës dhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës përmes veprave muzikore shqiptare dhe botërore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënit në muzikë janë të shumta dhe i japin mundësinë çdo nxënësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik që zotëron në vetvete. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efikase në orën e muzikës janë *Brainstorming, Klaster, Harta e të pyeturit, Diagrama e Venit, DDM, Harta e koncepteve, Kubimi, INSERT etj.*

## III. TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES




**Në stilin e të nxënit pamor dhe dëgjimor** veçojmë edhe teknikën e klasterit. **Klasteri** ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet "harta e mendimeve", është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë dhe duke i plotësuar ato më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore.



**PRO** **KUNDËR**

**A mund të themi se koncerti për violinë i Pjetër Gacit është më i bukur se vallet për violinë të Aleksandër Pecit?**

**Rrjeti i diskutimit** është një teknikë mësimdhënieje, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të kuptuar përmbajtjen muzikore të veprave dhe për t'i krahasuar ato. Përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Sipas kësaj teknike, klasa ndahet në dy grupe ("pro" dhe "kundër"). Grupet mund të jenë edhe mbi 20 vetë. Diskutimi midis grupeve vazhdon 15-25 minuta, sipas temës, dhe mund të realizohet me nxënës të çdo moshe.

**Brainstorming** është një veprimtari që bën pjesë në **stilin pamor**, por edhe dëgjimor, duke iu përshtatur lëndës së muzikës, sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim *QR code*, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera. Qëllimi i përdorimit të *Brainstorming*-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. *Brainstorming*-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga loja me përmasa të gjera dhe nga intensiteti i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura. *P.sh. shkruhet në dërrasë të zezë fjala "Muzika popullore shqiptare", ose vendoset për dëgjim një muzike popullore mjaft e njohur, ku nxënësve u kërkohet të flasin rreth asaj që dinë mbi muzikën popullore shqiptare, duke sjellë informacion mbi muzikën e krahinës së vet.*

Kjo teknikë kërkon të mbahet parasysh **që**:

- asnjë prej zgjidhjeve e ideve të mos kritikohet;
- të nxiten nxënësit të shprehin ide;
- diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura;
- të aktivizohen edhe nxënës të ndrojtur;
- të shërbejë si nxehje e trurit.




**Kubimi** është një teknikë që mund të futet tek **stili dëgjimor** sepse, përmes vendosjes së një vepre dëgjimore shqiptare, ndihmon shqyrtimin e veprës nga këndvështrime të ndryshme, për shkak të përjetimit emocional që është i ndryshëm tek gjithsecili. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa të shkurtra: *Përshkruaje, krahasoje, shoqëroje, analizoje, argumentoje (pro ose kundër)* p.sh.:

- vepr*ën* muzikore, këngën, muzikën popullore, dy kompozitorë, ku nxënësit udhëzohen të mendojnë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të mësuesit dhe ta përshkruajnë atë: (forma muzikore, karakteri i veprës, subjekti që trajton vepra, etj.).




**Tabela e koncepteve,** është një teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, një teknikë racionale për të organizuar informacionin muzikor përmes dëgjimit dhe krahasimit të disa veprave muzikore. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndihmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit pas leximit, si dhe në realizmin e skemave të qarta që sigurojnë qëndrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet apo njohuritë muzikore që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat, mbi bazën e të cilavebëhet ky krahasimi i veprave muzikore.




| TIPARE DALLUESE | TË PËRBASHKËTAT | TIPARE DALLUESE |
|---|---|---|
| o ____________ | o ____________ | o ____________ |
| o ____________ | o ____________ | o ____________ |
| o ____________ | o ____________ | o ____________ |

**Diagrama e Venit** është teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, me anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore, formave muzikore, ngjarjeve muzikore, kompozitorëve të ndryshëm, dy periudhave muzikore etj. Diagrama e Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.




**Harta e të pyeturit** është teknikë që i përket **stilit pamor dhe dëgjimor**.

Është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit, e cila shoqërohet me fragmente të ndryshme muzikore.

Përparësitë:

- *hap rrugën për diskutim;*

- *ndihmon nxënësit për të zhvilluar aftësi më të mëdha të të menduarit;*
- *tërheq nxënësit në punët e pavarura;*
- *rrit rolin e nxënësve në mësim;*
- *nxit të menduarit logjik;*
- *nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.*

Si të krijojmë një hartë të pyeturi? Për të përpiluar një hartë të tillë, mund të ndiqet kjo rregullsi:

- shkruhet tema e mësimit që do të shpjegohet në qendër të tabelës;
- pas kësaj, vizatohet harta e të pyeturit ku, pas pyetjeve kyç, gjenden të lidhura edhe pyetje të tjera që e zgjerojnë hartën.

**Të mësuarit me projekte (Projekti)**

Projekti kurrikular është strategji e të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin, përmes së cilës nxënësit, në mënyrë të pavarur ose/dhe si anëtarë të një grupi, hulumtojnë mbi çështje të caktuara ose probleme të lidhura me jetën reale. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.

- Projekti kurrikular në lëndën e muzikës është **rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit.**
- Projekti kurrikular **nuk** duhet të përmbajë njohuri të reja.
- Zbatimi i një projekti në lëndën e muzikës kërkon më shumë se një orë mësimore.
- Projekti kurrikular **mund** të jetë i shtrirë **përgjatë gjithë vitit shkollor**, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe **vetëm brenda një periudhe**. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e vet brenda vlerësimit të portofolit. Që kur e planifikon projektin, mësuesi duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit; mësuesi i vlerëson nxënësit gjatë zhvillimit të tij.

## IV. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Gjatë mësimit të muzikës për realizimin e kompetencave, mësimdhënësi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka ndikim të madh në muzikë, duke ndihmuar nxënësit/et të eksplorojnë këngë me tematika të ndryshme, për të rinj, arie, muzikale, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës. Tekstet dhe materialet sigurojnë, përmes përdorimit, një qasje të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të mediave, detyrave dhe projekteve të ndryshme nxënësve/eve u krijohet mundësia të demonstrojnë apo të prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh: për dëgjim muzikor, për shikim shfaqjesh, për ndjekjen e pjesëve muzikore, të këngëve përdoren magnetofoni ose QR code, TV-ja dhe DVD-ja. Përveç materialeve, shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

• *Mjetet audiovizive si:* TV, magnetofon ose QR code, video, video-projektor, kompjuter, internet, DVD.

• *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon ose QR code, etj.

• *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësues/it, fletoret e punës, katalogët, albumet që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.

• *Mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).

## V. ORGANIZIMI DHE KUPTIMI I TEKSTIT TË NXËNËSIT, SIPAS PROGRAMIT MËSIMOR

Ky tekst mësimor është organizuar në katër koncepte dhe tema mësimore. Ato janë:

1. **Krijimtaria dhe performanca artistike**

• këngë

• bllokflaut

• krijim muzikor

• krijim nëpërmjet solmizimit.

2. **Gjuha dhe komunikimi artistik**

• elementet muzikore

• shkrimi dhe leximi muzikor

• shkallët muzikore.

3. **Muzika dhe shoqëria**

• zhanret muzikore

• gjinitë muzikore

• instrumentet dhe formacionet muzikore

• krijues dhe interpretues.

4. **Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik**

• ngjarje muzikore

• vepra muzikore.

Në çdo njësi mësimore merren informacione të reja për këngët, veprat dhe kompozitorët nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive muzikore: këndim, dëgjim, interpretim dhe vlerësim. Në fund, zotërohen njohuri dhe aftësi të mjaftueshme muzikore e kulturore, të cilat provohen në një testim, koncert apo paraqitje të një teme të caktuar, duke punuar vetëm ose në grup.

## VI.KUPTIMI DHE INTERPRETIMI I SIMBOLEVE NË TEKSTIN E NXËNËSIT

| Simboli në tekstin e nxënësit | Kuptimi i simbolit siç e gjejmë në tekst |
|---|---|
| Dëgjo dhe diskuto | - dëgjim i vijës melodike të këngës / fragmente muzikore |
| Luajmë me bllokflaut | - luajtje në instrument |
| Mëso | - mëso (njohuri muzikore) |
| A e dini se... | - informacione mbi ngjarje muzikore, kompozitorë vendas dhe të huaj |
| Provo aftësitë e tua muzikore | - ushtrime ritmike dhe melodike, plotësime meloritmike<br>- krijime muzikore |
| Portofoli yt | - luaj dhe krijo muzikë<br>- çmo dhe vlerëso (këngën, krijimin, punimin, interpretimin)<br>- çmim dhe vlerësim i muzikës |
| Verifiko njohuritë | - vetëvlerësim dhe verifikim i njohurive muzikore të marra |
| | - QR code për dëgjimin e veprave muzikore dhe këngëve |

# PLANI VJETOR

**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE** **KLASA: GJASHTË**

| Lëndët e fushës | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallë |
|---|---|---|---|---|---|
| Lënda: Art muzikor | GJYSMËVJETORI I | | GJYSMËVJETORI II | | ***I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv***<br>I.3.<br>I.6.<br>I.7.<br>I.8.<br>I.9.<br>***II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ***<br>II.3.<br>II.5.<br>II.7.<br>II.8.<br>***III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm***<br>III.1.<br>III.2.<br>III.5.<br>***IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv***<br>IV.1.<br>IV.2.<br>IV.3.<br>IV.6.<br>***V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë***<br>V.2. |
| | **Shtator-Tetor**<br>**9 orë** | **Nëntor-Dhjetor**<br>**8 orë** | **Janar-Shkurt-Mars**<br>**9 orë** | **Prill-Maj-Qershor**<br>**9 orë** | |
| | Këngë (3 orë) | Këngë (2 orë) | Këngë (2 orë) | Këngë (1 orë) | |
| | Interpretime në instrumente (2 orë) | Interpretime në instrumente (1 orë) | Interpretime në instrumente (1 orë) | Interpretime në instrumente (1 orë) | |
| | - | Krijim muzikor (1 orë) | - | Krijim muzikor (1 orë) | |
| | Elementet muzikore (1 orë) | Elementet muzikore (1 orë) | - | | |
| | Shkrimi leximi muzikor (2 orë) | Shkrimi leximi muzikor (1 orë) | Shkrimi leximi muzikor (1 orë) | Shkrimi leximi muzikor (2 orë) | |
| | | | Format muzikore (1 orë) | | |
| | | Shkallët muzikore (1 orë) | Shkallët muzikore (1 orë) | | |
| | | | | | |
| | Instrumente muzikore (1 orë) | Instrumente muzikore (1 orë) | Zhanret muzikore (1 orë) | | |
| | | | Krijues dhe performues (1 orë) | Krijues dhe performues (2 orë) | |
| | | | Formacione artistike (1 orë) | Ngjarje artistike (1 orë) | |

| | | |
|---|---|---|
| | 1.1. Kënga himn<br>1.2. Bllokflauti<br>1.3. Vjeshta<br>1.4. Instrumentet me hark<br><br>1.5. Parashenja<br><br>1.6. Ritmi dhe pushimi 2/4<br><br>1.7. Luajmë në instrument<br><br>1.8. Atdhe<br><br>1.9. Struktura muzikore dhe elementet e saj<br><br>1.10. Alfabeti shqip<br><br>1.11. Forma dy dhe trepjesëshe<br><br>1.12.Ritmi 3/4 dhe pika e vlerës<br><br>1.13. Krijim me ritmet muzikore<br><br>1.14. Instrumentet frymore<br><br>1.15. Ninulla N<br><br>1.16. Luajmë në instrument<br><br>1.17. Përfaqësues dhe vepra<br><br>1.18. Ritmi 4/4<br><br>1.19. Luajmë në instrument<br><br>1.20. O lule e bukur<br><br>1.21. Shkalla muzikore G-Dur dhe e-mol | V.4.<br>***VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm***<br>VI.1.<br>VI.2.<br>VI.3.<br>VI.5. |

| | | |
|---|---|---|
| | 1.22. Instrumentet me dridhje<br>1.23. Format e thjeshta.<br>1.24. Vallja popullore<br>1.25. Formacionet instrumentale.<br>1.26. Shkalla muzikore F-Dur dhe d-mol<br>1.27. Ushtrime këndimi në G-Dur dhe F-Dur<br>1.28. O vendi im<br>1.29. Luajmë në instrument<br>1.30. Sinkopa dhe triola<br>1.31. Përfaqësues dhe vepra<br>1.32. Ritmi 3/8 dhe 6/8<br>1.33. Plotësoj dhe krijoj<br>1.34. Këngëtarë të shquar<br>1.35. Institucione dhe ngjarje artistike | |

**GJYSMËVJETORI I**

**MUAJT:** ***SHTATOR-TETOR/ NËNTOR-DHJETOR***
**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**
**LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR**
**KLASA: VI**

## KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

## TEMA: KËNGË, INTERPRETIME ME INSTRUMENTE DHE KRIJIMI MUZIKOR

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.6. Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm**

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv**

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm**

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

RNF.1.
**Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim**

- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.

**Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale**

- Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
- Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

## KONCEPTI: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

## TEMA: ELEMENTET E GJUHËS ARTISTIKE, SHKRIMI MUZIKOR

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.6. Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm**

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv**

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm**

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**RNF.2.**

- Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta.
- Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura.
- Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre.
- Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).

**KONCEPTI: MUZIKA DHE SHOQËRIA**

**TEMA MËSIMORE: INSTRUMENTE ET MUZIKORE, KRIJUES DHE PERFORMUES**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.6. Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm**

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv**

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:**

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**RNF.3.**

- Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave te ndryshme.
- Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.).
- Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regjional, kombëtar, global etj.).

| GJYSMËVJETORI I | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MUAJT: *SHTATOR-TETOR (9 orë) / NËNTOR- DHJETOR (8 orë)*<br>17 orë | | | | | | | |
| **Temat mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore** | **Njësitë mësimore** | **Koha e mësimore (orë mësimore)** | **Metodologjia e mësimdhënies** | **Metodologjia e vlerësimit** | **Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare** | **Burimet** |
| **Këngët** | këndojnë melodi të thjeshta me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 8-10 këngë gjatë vitit shkollor) duke respektuar teknikën e këndimit të drejtë e të bukur. | 1.1. Kënga himn<br>1.3. Vjeshta<br>1.8. Atdhe<br>1.10. Alfabeti shqip<br>1.15. Ninulla N | 5 orë | Bisedë<br>Diskutim<br>Brainstorming<br>Diagrama e Venit<br>Harta e të pyeturit<br>Kllaster<br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br>Portofolio e nxënësit/es<br>Vlerësim i ndërsjellë | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti'<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>- Globalizimi dhe ndërvarësia | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br>Qr code<br>CD<br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | **-** Edukimi për media<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>**-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br>**-** Edukimi për media | |
| **Interpretim në intrumente muzikore** | luajnë në instrumente, individualisht dhe në grupe (së paku 3 -5 pjesë instrumentale) me dhe pa tekst notal, si dhe shoqërojnë këndimin me instrumente muzikore që përdorin. | 1.2.Bllokflauti<br><br>1.7.Luajmë në instrument<br><br>1.7.Luajmë në instrument | 3 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Demonstrim<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofolio e nxënësit/es<br><br>Vlerësim i ndërsjellë | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti'<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br><br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>**-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br>**-** Edukimi për media | Teksti shkollor Softuerë arsimorë,<br><br>Qr code<br><br>CD<br><br>DVD |
| **Krijim muzikor** | improvizojnë ritme dhe melodi në masën 2\4,3\4, 4/4 dhe \5\8, e 6\8.<br><br>shprehen me mjete shprehëse të | 1.13. Krijim me ritmet muzikore | 1 orë | | | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | arteve mbi muzikën e dëgjuar.<br><br>provojnë të krijojnë melodi të reja për ritme e tekste të shkurtra poetike të përzgjedhura. | | | | | **Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br>- Edukimi për media | |
| **Shkrimi leximi muzikor** | identifikojnë simbolet muzikore për lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore (rrokjet e solmizimit, vlerat e notave) të këngëve që këndojnë.<br><br>lexojnë ritmikisht saktë ushtrimet në masat e caktuara ku kombinohen vlerat e ndryshme ritmike. | 1.5. Parashenja<br><br>1.6. Ritmi dhe pushimi 2/4<br><br>1.12. Ritmi 3/4 dhe pika e vlerës | 3 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Brainstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Harta e të pyeturit<br><br>Klaster<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofolio e nxënësit/es<br><br>Vlerësim i ndërsjellë | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti’<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br><br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br>- Edukimi për media | Teksti shkollor Softuerë arsimorë,<br><br>Qr code<br><br>CD<br><br>DVD |
| **Elementet bazike të gjuhës artistike** | dallojnë elementet muzikore (ritmi, masat, melodia, harmonia, | 1.9. Struktura muzikore dhe elementet e saj<br><br>1.11. Forma | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Brainstorming | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofolio e | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti’ | Teksti shkollor Softuerë arsimorë, |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | shkallët muzikore etj.) në veprat që dëgjojnë.<br><br>përdorin elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore.<br><br>identifikojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore (dy pjesore dhe tre pjesore, minuet, vals etj.). | dy- dhe trepjesëshe | | Diagrama e Venit<br><br>Harta e të pyeturit<br><br>Klaster<br><br>Punë individuale | nxënësit/es<br>Vlerësim i ndërsjellë | - Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br><br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br>- Edukimi për media | Qr code<br><br>CD<br><br>DVD |
| **Krijues dhe performues** | njohin vepra artistike dhe krijues artistë të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.*(së paku 10).* | 1.17. Përfaqësues dhe vepra | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Brainstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Harta e të pyeturit<br><br>Kllaster<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofolio e nxënësit/es<br>Vlerësim i ndërsjellë | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti'<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br><br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>- Zhvillimi personal dhe | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>Qr code<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | shkathtësitë për jetë<br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br>**-** Edukimi për media | |
| **Instrumentet muzikore** | dallojnë instrumentet përfaqësuese nga grupet e instrumenteve harkore, frymore dhe me goditje. | 1.4. Instrumentet me hark<br><br>1.14. Instrumentet frymore | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Brainstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Harta e të pyeturit<br><br>Kllaster<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofolio e nxënësit/es<br>Vlerësim i ndërsjellë | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti'<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br><br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>**-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br>**-** Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>Qr code<br><br>CD<br><br>DVD |

**GJYSMËVJETORI II**

**MUAJT: JANAR-MARS**
**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**
**LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE**
**KLASA: II**

## KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

## TEMA: KËNGËT DHE INTERPRETIME ME INSTRUMENTE

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.6. Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm**

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv**

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm**

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

RNF.1.
**Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim**

- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.

## TEMA: ELEMENTET E GJUHËS ARTISTIKE DHE SHKRIMI MUZIKOR

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.6. Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm**

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv**

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:**

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**RNF.2.**

- Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta.
- Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura.
- Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre.
- Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë te tjerë, publik më i gjerë etj.).

**KONCEPTI: MUZIKA DHE SHOQËRIA**

**TEMA MËSIMORE: INSTRUMENTE ET MUZIKORE DHE FORMACIONET ORKESTRALE**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.6. Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm**

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv**

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm**

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**RNF.3.**

- Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave te ndryshme;
- Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.
- Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regjional, kombëtar, global etj.).

| GJYSMËVJETORI II | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MUAJT: *JANAR-MARS (11 orë)* | | | | | | | |
| **Temat mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore** | **Njësitë mësimore** | **Koha e mësimore (orë mësimore)** | **Metodologjia e mësimdhënies** | **Metodologjia e vlerësimit** | **Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare** | **Burimet** |
| **Këngët** | këndojnë melodi të thjeshta me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 8-10 këngë gjatë vitit shkollor) duke respektuar teknikën e këndimit të drejtë e të bukur. | 1.20. O lule e bukur<br><br>1.24. Vallja popullore | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Brainstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Harta e të pyeturit<br><br>Kllaster<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofolio e nxënësit/es<br><br>Vlerësim i ndërsjellë | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br><br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>Qr code<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | **-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br>**-** Edukimi për media<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>**-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br>**-** Edukimi për media | |
| **Interpreti m në intrument e muzikore** | luajnë në instrumente, individualisht dhe në grupe (së paku 3-5 pjesë instrumentale) me dhe pa tekst notal, si dhe shoqërojnë këndimin me instrumente muzikore që përdorin. | 1.19.Luajmë në instrument | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Demonstrim<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofolio e nxënësit/es<br><br>Vlerësim i ndërsjellë | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>- Shoqëria dhe mjedisi,<br>- Gjuhë angleze,<br>- Matematikë<br><br>**Çështjet ndërkurrikulare**<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>**-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br>**-** Edukimi për media | Teksti shkollor Softuerë arsimorë,<br><br>Qr code<br><br>CD<br><br>DVD |
| **Shkrimi leximi muzikor** | identifikojnë simbolet muzikore për lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore (rrokjet e solmizimit, | 1.21. Shkalla muzikore G-Dur dhe e-moll | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim | Buletini i pjesëmarrjes | - Njeriu dhe natyra,<br>- Gjuhë shqipe,<br>- Art figurativ,<br>- Art muzikor,<br>- Edukata fizike, sporte dhe | Teksti shkollor Softuerë arsimorë, |

| | | | | | | | |
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Përfaqësues dhe vepra</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalë kyçe: kompozim, përkryerje artistike</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br><br>- identifikon përfaqësues dhe interpretues të muzikës botërore përmes dëgjimit;<br><br>- shfaq parapëlqimin e vet për veprën/gjininë që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar fragmente muzikore të ndryshme;<br><br>- sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës botërore;<br><br>- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.<br><br>- ndan njohuritë e veta me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, QR code, mjete të tjera për të punuar.</td></tr>
</table>

**Materiali nga interneti**

- Zhan Batist Lyli (youtu.be/2RM-6_bqXVs);
- Georg Fridrih Hendel (youtu.be/JH3T6YwwU9s);
- Johan Sebastian Bah (youtu.be/PSVlG6wuXjo);
- Volfgang Amadeus Moxart (youtu.be/a_0FHyF3Pyk);
- Franc List (youtu.be/ALqOKq0M6ho).

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

*Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet*

*Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko-kulturore.*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* (5 minuta)**

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (**brainstorming**), përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave nga interpretues dhe kompozitorë të ndryshëm botërorë. Vendosen QR code me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit i identifikojnë. Ata flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.

***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **teknikën Harta e të pyeturit**, ku mësimdhënësi paraqet lloje të ndryshme instrumentesh muzikore, nëpërmjet një posteri ose një projektori dhe u kërkon nxënësve/eve t'i identifikojnë ato sipas njohurive që kanë marrë ose përjetuar.

Vazhdohet me vendosjen e disa fotove nga kompozitorë të ndryshëm të mëdhenj të muzikës botërore dhe interpretues botërorë.

Nxiten nxënësit të flasin rreth tyre me informacionin që kanë dhe njohuritë që marrin nëpërmjet librit të tyre të muzikës.

Nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, *Youtube*, nxënësit/et sjellin kuriozitete rreth krijuesve, interpretuesve dhe përfaqësuesve që kanë:

- shkruar për këto instrumente;
- kanë luajtur në këto instrumente;

dhe i kanë zhvilluar më tej këto instrumente muzikore, duke i diskutuar punët e tyre me shokët.

***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:* (10 minuta)**

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës **Diagrama e Venit** ku vendosen dy kompozitorë të shquar, Bahu dhe Moxarti dhe ajo që i bashkon ata është kombësia austriake.

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:

Luajtja në instrumentin e pianos

Krijimet metodike që ata kanë shkruar për instrumentin e pianos, por jo vetëm etj.

| |
|---|
| **Vlerësimi**<br><br>Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:<br><br>N2: dëgjimin e fragmenteve muzikore nga përfaqësues të muzikës botërore;<br><br>N3: shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë disa karakteristika të veprës muzikore që dëgjon;<br><br>N4: grumbullimin dhe prurjen në klasë me QR code/DVD të pjesëve instrumentale, sipas klasifikimit të veprave nga përfaqësues të parapëlqyer;<br><br>N4: bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **interpretime nga repertori i kompozitorëve të ndryshëm botërorë** me anë të përdorimit të mediave (DVD, QR code, magnetofon), i grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re. |

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Art muzikor</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VI (gjashtë)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor<br><br>Tema: “Shkrim-leximi muzikor”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br><br>- identifikojnë simbolet muzikore për lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore (rrokjet e solmizimit, vlerat e notave) të këngëve që këndojnë;<br><br>- lexojnë ritmikisht saktë ushtrimet në masat e caktuara ku kombinohen vlerat e ndryshme ritmike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.<br><br>II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br><br>II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br><br>III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.<br><br>III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.<br><br>IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.<br><br>V.2. Dëshmim i vetëbesimit.<br><br>VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>RNF.2.<br>- përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: “Ritmi 4/4”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalë kyçe: ritëm, 4/4, pushim i masës 4/4, theks i fortë, theks i butë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br><br>- krijon në kohët 4/4;<br>- lexon dhe këndon në kohën 4/4;<br>- krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh;<br>- shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë përdorimit të vlerave ritmike të notave dhe pushimeve;<br>- respekton punën e vet dhe të shokut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, mjete të tjera për të punuar.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

*Fusha: Matematika*

*Përdorimi i shenjave dhe simboleve në një kontekst të dhënë.*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* (5 minuta)**

Mësimi fillon me një **brainstorming** ku mësimdhënësi shkruan në dërrasë të zezë fjalë me tri rrokje dhe kërkon nga nxënësit t'i ligjërojnë ato me kujdes, duke theksuar më fort rrokjen e duhur Ta.






***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

Vazhdohet më tej veprimtarinë, duke u rikujtuar nxënësve/eve mësimin ku ata kanë punuar me ritmin 4/4 dhe e notës si njësi ritmike.

Shpjegohet koha 4/4 dhe **theksi i fortë e i butë dhe gjysmë i fortë** ku bie, nëpërmjet rrokjeve të fjalëve në fillim dhe më pas vijohet edhe me shembuj të tjerë ritmikë.




U shpjegohen si **rrihet masa 4/4,** dhe cilat janë simbolet e tjera që plotësojnë ritmin 4/4.



**Pushimi 4/4** është simboli ku nxënësit fiksojnë se shkruhet në fushën e katërt të pentagramit me kokë poshtë.



Më pas nxënësit fillojnë të krijojnë vetë ritme 4/4, për ta kuptuar më mirë këtë ritëm. Ata fillojnë ndarjen e ushtrimit në masa atje ku duhet.

Vazhdojnë me plotësimin e ushtrimeve në tekstin e tyre ku përdorin me kombinime të ndryshme notash dhe pushimesh. Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato.




**Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:

N2: krijimin në kohët 4/4;

N2: leximin dhe këndimin në kohën 4/4;

N3: krijimin duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh në ritmin 4/4;

N4: shpjegimin e përdorimit të vlerave ritmike të notave dhe pushimeve;

N4: respektimin e punës së vet dhe të shokut.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit të krijojnë ushtrime në ritmin 4/4 me vlera të ndryshme ritmike në 8 masa muzikore.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (masën 4, pushimin e masës 4/4).

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Arte** | **Lënda: Art muzikor** | **Shkalla e kurrikulës:** ***III*** | **Klasa:** ***VI (gjashtë)*** |
| **Konceptet:** Krijimtaria dhe performanca artistike<br><br>**Tema:** Interpretim në instrumente | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br><br>- luan individualisht dhe në grup, pjesë instrumentale, me dhe pa tekst notal si dhe shoqërojnë këndimin me instrumente muzikore që përdorin. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br><br>I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.<br><br>II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br><br>II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br><br>III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.<br><br>IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.<br><br>V.2. Dëshmim i vetëbesimit.<br><br>VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**<br><br>**RNF. 1.**<br><br>- luajnë në instrumente, individualisht dhe në grupe (së paku 3-5 pjesë instrumentale) me dhe pa tekst notal, si dhe e shoqërojnë këndimin me instrumentet muzikore që përdorin. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** *Luajmë në instrument* | | | |
| **Fjalë kyçe:** *rregullat e luajtjes në instrument, ritëm, melodi* | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br><br>- luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara;<br>- luan në instrument, duke respektuar rregullat e këtij instrumenti;<br>- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;<br>- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br><br>*Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, instrumenti muzikor, mjete të tjera për të punuar.* | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore** | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** | | | |

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Mësimi fillon me një veprimtari **(bisedë)** me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të rikujtojnë rregullat e luajtjes në instrument dhe bërë nxehjen me të.







**Ndërtimi i njohurive të reja**

**Vazhdohet** puna me mësimin e hapave të lojës së gotave në *stilin dëgjimor* dhe *kinestetik* të të nxënit.

**Demonstrohet** ekzekutimi nga mësimdhënësi, pastaj nga nxënësit ushtrim me instrumentin e bllokflautit.

Më pas vazhdohet ekzekutimi me ushtrimet që ka teksti.

***Vlerësimi***

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:

N2: demonstrimin me korrektësi të luajtjes me instrument;

N3: zbatimin korrekt të ushtrimeve në fyell, duke respektuar rregullat e luajtjes;

N4: ekzekutimin dhe bashkëpunimin gjatë mësimit të ushtrimeve me bllokflaut.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit për çmuarjen dhe vlerësimin e ekzekutimit të shokut dhe shoqes në instrument.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Art muzikor</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VI (gjashtë)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br><br>Tema: Këngët</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br><br>- këndojnë melodi të thjeshta me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 8-10 këngë gjatë vitit shkollor) duke respektuar teknikën e këndimit drejt e bukur.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br><br>I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.<br><br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br><br>III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.<br><br>IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.<br><br>V.2. Dëshmim i vetëbesimit.<br><br>VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>RNF.1.<br><br>- demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim;<br><br>- këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Kënga O lule e bukur</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br><br>- komunikon qartë njohuritë muzikore, duke lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;<br>- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;<br>- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;<br>- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;<br>- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, QR code, mjete të tjera për të punuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “lule”, “kujdes”, “dashuri”.</td></tr>
</table>

| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**<br>Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke u kërkuar atyre të tregojnë rreth kujdesit ndaj luleve që ata pëlqejnë më shumë, duke veçuar lulen e tyre të preferuar. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin, Diskutohen situata të përjetuara me njëri-tjetrin.<br><br>**Ndërtimi i njohurive të reja**<br><br>**Vazhdohet** puna me mësimin e këngës O lule e bukur, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.<br><br>**Vendoset** për dëgjim kënga dhe bëhet:<br>> dëgjimi i vijës melodike të këngës në QR code;<br>> procedura metodike – ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);<br>> demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;<br>> këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga QR code – me vesh nga nxënësit;<br>> mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;<br>> mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;<br>> interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;<br>> këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;<br>> përvetësimi i këngës: *përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*<br>> përkryerja artistike e këngës: *këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*<br><br>Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.<br><br>***Demonstrimi i rezultateve të arritura***<br><br>Nxënësit:<br><br>- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth luleve dhe kujdesit të tyre.<br><br>- Thonë pse iu pëlqen kjo këngë. |
| **Vlerësimi**<br>Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:<br>N2: këndimin e këngës me të tjerët;<br>N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;<br>N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;<br>N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës). |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re. |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Arte** | **Lënda: Art muzikor** | **Shkalla e kurrikulës:** ***III*** | **Klasa:** ***VI (gjashtë)*** |
| **Konceptet:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema:** "Shkrim-leximi muzikor" | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br><br>- identifikojnë parimin e ndërtimit të shkallëve muzikore (C-Dur-a-mol, G-Dur-e-mol dhe F-Dur-d-mol) përmes këngëve, shembujve muzikorë për dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br><br>I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive.<br><br>II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br><br>II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br><br>III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.<br><br>III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.<br><br>IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.<br><br>V.2. Dëshmim i vetëbesimit.<br><br>VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**<br><br>**RNF. 2.**<br><br>- përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta;<br>- zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** *Shkalla muzikore G-Dur dhe e-mol* | | | |
| **Fjalë kyçe:** *shkallë maxhore, shkallë minore, shkalla G–Dur dhe e-mol, akord, arpezh, T, ½ T* | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br><br>- kupton ndërtimin e shkallës muzikore G-Dur dhe e-mol;<br>- shpjegon funksionin e T nga ½ T në ndërtimin e shkallëve muzikore;<br>- këndon akordin dhe arpezhin e shkallëve muzikore;<br>- këndon gradët e shkallës në ngjitje dhe në zbritje. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br><br>*Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, mjete të tjera për të punuar.* | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br><br>Matematika | | | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* (5 minuta)**

Mësimi fillon me një **brainstorming** ku mësimdhënësi vendos disa numra dhe simbole mjaft

të njohura për nxënësit/et, të cilat përdoren në matematikën I, II, III, IV etj., si dhe < > dhe i nxit që të diskutojnë dhe të nxjerrin kuptimin që kanë ato. Çfarë roli dhe funksioni mund të luajnë edhe në muzikë?

Diskutimet i ndihmojnë që ata/ato të kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet në jetën tonë të përditshme.

***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësimdhënësi fillon:




Shpjeguar **shkallën G-Dur** dhe **e-mol** dhe **akordin dhe arpezhin.**

Më pas ndërton shkallën Sol maxhor në dërrasë dhe shpjegon kuptimin e gradëve në muzikë, të tonit dhe ½ tonit. Gjatë ndërtimit të shkallës dhe vendosjes së gradëve dhe T e ½ T, shkalla do të marrë formën e saj të plotë me të gjitha elementet e saj.







**Shkalla G-Dur – akordi dhe arpezhi**
**Shkalla e-mol – akordi dhe arpezhi**









| |
|---|
| Nxënësit lexojnë dhe këndojnë ushtrime në tonalitetin Sol maxhor dhe Mi minor, duke i plotësuar me të gjitha elementet përkatëse.<br><br>***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:* (10 minuta)**<br><br>Përsëritin njohuritë e marra nëpërmjet **diskutimeve** mbi shkallët muzikore të mësuara.<br><br>**Vlerësimi**<br><br>Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:<br><br>N2: ndërtimin e shkallës muzikore G-Dur dhe e-mol;<br><br>N3: shpjegimin funksionin e T nga ½ T në ndërtimin e shkallëve muzikore;<br><br>N4: këndimin e shkallëve dhe akordit/arpezhit të shkallëve muzikore;<br><br>N4: bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës, vetëm ose në grup. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Udhëzohen nxënësit të punojnë me ushtrimet e paraqitura në tekst me shkallët muzikore. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (shkallët muzikore G-dur dhe e-mol). |

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

| **Fusha kurrikulare: Arte** | **Lënda: Art muzikor** | **Shkalla e kurrikulës:** ***III*** | **Klasa:** ***VI (gjashtë)*** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Konceptet:** Muzika dhe shoqëria<br><br>**Tema:** "Instrumentet me dridhje" | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br><br>- dallojnë instrumentet përfaqësuese nga grupet e instrumenteve harkore, frymore dhe me goditje. |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.

V.2. Dëshmim i vetëbesimit.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

**RNF.3.**

- identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj).

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** *"Instrumentet me dridhje"*

**Fjalë kyçe:** *kitara, mandolina, harpa*

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- identifikon përmes pamjes instrumentet muzikore me dridhje;
- klasifikon instrumentet muzikore sipas materialit dhe ndërtimit që kanë;
- shfaq parapëlqimin e vet për instrumentin që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar mendimin e vet;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

*Teksti i nxënësit, Art muzikor 6,* QR *code, mjete të tjera për të punuar.*

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

*Fusha: Shkencat natyrore – fizika*

*Përcaktimi i lartësisë tingullore të instrumenteve të ndryshme në lëndën e fizikës.*

**Materiale nga interneti (QR code)**

Instrumentet me dridhje:

- harpa (youtu.be/rv5vXFaKkIg);
- kitara (youtu.be/Et6cmagw_t4);
- mandolina (youtu.be/ikHCVWv1uvg).

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* (5 minuta)**

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku zhvillohet një kuic i shkurtër, përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore gjatë 20-30 sekondave. Vendosen QR code me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit i identifikojnë. Ata flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh

***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësimdhënësi paraqet lloje të ndryshme instrumentesh muzikore, nëpërmjet një posteri ose një projektori dhe u kërkon nxënësve/eve t'i identifikojnë ato sipas njohurive që kanë. Më pas, vendos QR code me fragmente muzikore dhe nxënësit/et dallojnë instrumentet që dëgjojnë (*kitara, mandolina, harpa*).

Ata bëjnë gjithashtu krahasimin e cilësive të timbrit të instrumenteve që dëgjojnë, duke gjetur arsyen pse ndryshojnë prej njëri-tjetrit (përbërja dhe ndërtimi i tyre). Të gjitha arsyet i shënojnë në fletore ose në dërrasë të zezë.

Nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, *Youtube*, nxënësit/et sjellin kuriozitete rreth krijimit dhe evoluimit të instrumenteve muzikore dhe i diskutojnë ato me shokët.

***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:* (10 minuta)**
Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës **Diagrama e Venit** ku vendosen instrumente me pamjet të ndryshme, por nga e njëjta familje.

**Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:

N2: dëgjimin e fragmenteve muzikore instrumentale, duke bërë klasifikimin e instrumenteve muzikore;

N3: shpjegimin e timbrit të tingullit që lëshon instrumenti, sipas përbërjes dhe ndërtimit të tij;

N4: dallimin e pjesëve të ndryshme muzikore instrumentale, ku shpjegon pse i pëlqen një instrument i caktuar;

N4: gjetjen dhe prurjen në klasë me QR code/DVD të pjesëve instrumentale, sipas klasifikimit të instrumenteve të parapëlqyera.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **pjesë instrumentale** me përdorimin e mediave (DVD, magnetofon ose QR code), i grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Art muzikor</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VI (gjashtë)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor<br><br>Tema: “Elementet muzikore”<br><br>Ritmi, harmonia, melodia, forma</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br><br>- identifikojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore (dy-pjesore dhe tri-pjesore, minuet, vals etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br><br>I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive.<br><br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br><br>III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme<br><br>III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.<br><br>IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.<br><br>V.2. Dëshmim i vetëbesimit.<br><br>VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>RNF.2.<br>• - përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta;<br>• - zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: “Format e thjeshta”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalë kyçe: forma muzikore, minueti, valsi, rondoja</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br><br>- lidh njohuritë që ka ndërmjet asaj që di mbi format muzikore;<br>- bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, elementët që përbëjnë në formën muzikore;<br>- shpjegon karakteristikat e formave të thjeshta muzikore: vals, rondo dhe minuet;<br>- komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara, duke përcaktuar formën e tyre muzikore;<br>- përdor fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, QR code, mjete të tjera për të punuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Materiali nga interneti<br><br>- Valsi “Danubi blu”, Johan Shtraus II (youtu.be/_CTYmbbEL4).</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

*Fusha: Arti pamor*
*Përdorimi i koncepteve të artit pamor për të krijuar forma të ndryshme artistike.*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* (5 minuta)**

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një **brainstorming** përmes një dëgjimi të një Valsi të thjeshtë nxënësit diskutojnë me karakteristikat e valsit.

***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

Vendosen për dëgjim tri këngë të ndryshme dhe diskutohet çfarë dallohet përmes dëgjimit. (Ato kanë forma 1-, 2-, 3-pjesëshe).

**Shpjegohet:**

**Ç'është valsi?** **Ç'është minuet**i?













***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:* (10 minuta)**

Përsëritin njohuritë e marra mbi format e thjeshta muzikore.

**Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:

N2: lidhjen e njohurive që ka ndërmjet asaj që di mbi format muzikore;

N3: komunikimin e mendimit të vet rreth veprave muzikore të dëgjuara duke përcaktuar formën e tyre muzikore;

N4: shpjegimin e karakteristikave të formave të thjeshta muzikore: *valsi dhe minueti*;

N4: gjykimin kritik ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, në elementet që e përbëjnë, *në formën muzikore.*

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit në çmuarjen e njohurive muzikore dhe vlerësimin e tyre.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Art muzikor</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VI (gjashtë)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br><br>Tema: “Formacionet muzikore”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br><br>- dallojnë ansamblet e ndryshme muzikore sipas funksionit dhe llojit.<br><br>- dallojnë muzikën skeniket, koret dhe orkestrën.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br><br>I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.<br><br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br><br>III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.<br><br>III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.<br><br>IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.<br><br>V.2. Dëshmim i vetëbesimit.<br><br>VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>RNF.3.<br>- identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave te ndryshme;<br><br>- identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: “Formacionet instrumentale”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalë kyçe: kuartet, muzikë dhome, bandë, fanfarë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br><br>- dëgjon dhe identifikon ndonjë lloj formacioni instrumental muzikor;<br>- klasifikon formacionet muzikore sipas njohurive që merr;<br>- shfaq parapëlqimin e vet për një formacion muzikor, duke sjellë shembuj të ndryshëm dëgjimorë me QR code;<br>- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/ shoqeve gjatë diskutimeve të dëgjimit të pjesëve;<br>- muzikore;<br>- ndan njohuritë e veta me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, QR code, mjete të tjera për të punuar.</td></tr>
</table>

**Materiale nga interneti**

- Banda e parë muzikore shqiptare (youtu.be/i5pM9JpvaTE).

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** **(5 minuta)**

Mësimi fillon me një veprimtari konkrete **Brainstorming** ku vendosen postera/fotografi të formacioneve të ndryshme muzikore dhe nxiten nxënësit të flasin rreth tyre.

Por mund të vendoset edhe QR code me fragmente të shkurtra muzikore, duke i nxitur përsëri nxënësit të gjejnë se çfarë informacioni kanë për formacionet muzikore që dëgjojnë. Të gjithë nxënësit shprehin njohuritë e tyre dhe respektojnë mendimin e njëri-tjetrit. Zhvillohet një kuic i shkurtër, përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave.






***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësimdhënësi vendos shembuj muzikorë të luajtur nga formacione të ndryshme muzikore.
Nxitet vëmendja për një dëgjim të kujdesshëm, që të kuptohet ndryshimi jo vetëm nëpërmjet përbërjes së numrit që ka një formacion muzikor, por edhe nëpërmjet identifikimit nëpërmjet dëgjimit.
Nxënësit/et, pasi kanë dëgjuar disa pjesë të ekzekutuara nga këto formacione, përzgjedhin formacionin muzikor që do të dëshironin të dëgjonin më shpesh në *Youtube, QR code etj.*
Mësimdhënësi shpjegon evoluimin e formacioneve muzikore nga krijimi deri në ditët tona.
***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:*** **(10 minuta)**
Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës **Diagrama e Venit** ku vendosen instrumente me pamjet të ndryshme, por nga e njëjta familje. P.sh.:
Banda

**Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:

N2: dëgjimin e fragmenteve muzikore instrumentale, duke bërë klasifikimin e instrumenteve muzikore;

N3: shpjegimin e timbrit të tingullit që lëshon instrumenti, sipas përbërjes dhe ndërtimit të tij;

N4: bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **pjesë instrumentale me** përdorimin e mediave (DVD, QR code, magnetofon ose QR code), i grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Arte** | **Lënda: Art muzikor** | **Shkalla e kurrikulës:** ***III*** | **Klasa:** ***VI (gjashtë)*** |
| **Konceptet:** Krijimtaria dhe performanca artistike<br><br>**Tema:** Këngët | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br><br>- këndojnë melodi të thjeshta me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 8-10 këngë gjatë vitit shkollor) duke respektuar teknikën e këndimit drejt e bukur. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br><br>I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br><br>I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.<br><br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br><br>III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.<br><br>IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.<br><br>V.2. Dëshmim i vetëbesimit.<br><br>VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**<br><br>**RNF.1.**<br><br>- demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim;<br><br>- këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Kënga "Vallja popullore" | | | |
| **Fjalë kyçe:** tekst i këngës, melodi, interpretim | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br><br>- komunikon qartë njohuritë muzikore, duke lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;<br><br>- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;<br><br>- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;<br><br>- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;<br><br>- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br><br>*Teksti i nxënësit, Art muzikor 6,* QR *code, mjete të tjera për të punuar.* | | | |
| **Materiali nga interneti**<br><br>- Vallja popullore (youtu.be/fwaNMP2ol9o). | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br><br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve "Valle popullore", "Identitet kombëtar", "Trashëgimi kulturore" | | | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke u kërkuar atyre të tregojnë rreth valles së parapëlqyer që ata pëlqejnë dhe kërcejnë më shumë. I diskutojnë ato me njëri-tjetrin, Diskutohen situata të përjetuara me njëri-tjetrin.

**Ndërtimi i njohurive të reja**

**Vazhdohet** puna me mësimin e këngës "Vallja popullore", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

**Vendoset** për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në QR code;

procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga);

- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën;
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga QR code – me vesh nga nxënësit;
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral;
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim;
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë;
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram;
- përvetësimi i këngës: *përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave;*
- përkryerja artistike e këngës: *këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

I

Pran' burimit dor' për dore
Hidhet vallja popullore
Hej hedhim valle, valle t'madhe
Djemt' e çupat sy sorkadhe

II

Her' në gishta her' në thembër
Hidhen t'gjith' si me një zemër.
Hej zemra zemra dor' për dor'
Hidhet vallja popullore

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

***Demonstrimi i rezultateve të arritura***
Nxënësit:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth luleve dhe kujdesit të tyre;
- thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

**Vlerësimi**
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:
N2: këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
N3: interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
N4: respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve;
N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

| Fusha kurrikulare: Arte | Lënda: Art muzikor | Shkalla e kurrikulës: *III* | Klasa: *VI (gjashtë)* |
|---|---|---|---|

**Konceptet:** Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor

**Tema:** "Shkrim-leximi muzikor"

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- identifikon parimin e ndërtimit të shkallëve muzikore (F-Dur dhe d-mol).

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive.

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar aftësitë që zotëron.

V.2. Dëshmim i vetëbesimit.

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

**RNF. 2.**

- zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** *"Shkalla muzikore F-Dur dhe d-mol"*

**Fjalë kyçe:** *shkallë maxhore, shkallë minore, Shkalla F–Dur dhe d-mol, akord, arpezh, T, ½ T*

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Kupton ndërtimin e shkallës muzikore F-Dur dhe d-mol;
- shpjegon funksionin e T nga 1/2 T në ndërtimin e shkallëve muzikore;
- këndon akordin dhe arpezhin e shkallëve muzikore;
- këndon gradët e shkallës në ngjitje dhe në zbritje.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

*Teksti i nxënësit, Art muzikor 6, mjete të tjera për të punuar.*

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Matematika

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* (5 minuta)**

Mësimi fillon me një **brainstorming** ku mësimdhënësi ku vendos disa numra dhe simbole mjaft të njohura për nxënësit/et që përdoren në matematikë I, II, III, IV etj., si dhe < > dhe i nxit që të diskutojnë dhe të nxjerrin kuptimin që kanë ato. Çfarë roli dhe funksioni mund të luajnë edhe në muzikë?

Diskutimet ndihmojnë që ata/ato të kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet në jetën tonë të përditshme.

***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësimdhënësi fillon duke shpjeguar **shkallën F-Dur** dhe d-**mol** dhe **akordin dhe arpezhin.**

Më pas ndërton shkallën Sol maxhor në dërrasë dhe shpjegon kuptimin e gradëve në muzikë dhe T dhe 1/2 tonit.

Gjatë ndërtimit të shkallës dhe vendosjes së gradëve dhe T e 1/2 T shkalla do të marrë formën e saj të plotë me të gjitha elementet e saj.

**Shkalla F-Dur - akordi dhe arpezhi**







**Akordi dhe arpezhi**

**Shkalla d-mol dhe akordi dhe arpezhi**




**Akordi dhe arpezhi i shkallës d-mol.**




Nxënësit lexojnë dhe këndojnë ushtrime në tonalitetin Fa maxhor dhe Re minor duke plotësuar me të gjitha elementet përkatëse.

***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:* (10 minuta)**

Përsëritin njohuritë e marra nëpërmjet **diskutimeve** mbi shkallët muzikore të mësuara.

**Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:

N2: ndërtimin e shkallës muzikore F-Dur dhe d-mol;

N3: shpjegimin funksionin e T nga 1/2 T në ndërtimin e shkallëve muzikore;

